




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe
Inovacionit/Ministartstvo Obrazovanja i
Nauke, Tehnologije i Inovacija / Ministry of Education,
Science, Technology and Innovation

Nr. 01B/299 Prot.

Datë 06.07.2022



Nr. 4501/1 Prot.

Datë 4.7.2022

VENDIM/URDHËR I PËRBASHKËT

PËR

MIRATIMIN E TEKSTIT TË VETËM TË PËRBASHKËT “ABETARE”

Me propozim të Komisionit të Përbashkët Shqipëri - Kosovë për procedurat e organizimit të konkursit për tekstin e vetëm të përbashkët “Abetare”, në zbatim të programit të përbashkët të bashkëpunimit, ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës, “Për procedurat e organizimit të konkursit për tekstin e vetëm të përbashkët të “Abetares”, datë 21.12.2021; të urdhrin nr. 504, datë 28.12.2021, “Për caktimin e përfaqësuesve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në komisionin e përbashkët për organizimin e konkursit për tekstin e vetëm të përbashkët “Abetare””; të vendimit nr. 01B/002, datë 11.01.2022, të ministrit të Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës:

VENDOS/URDHËROJ:

1. Miratimin e tekstit të vetëm të përbashkët “Abetare”, i shtëpive botuese “Botime Pegi” Shqipëri dhe “Dukagjini” Kosovë, i renditur i pari në listën fituese të konkursit për tekstin e vetëm të përbashkët “Abetare”.

2. Shtëpitë botuese “Botime Pegi” dhe “Dukagjini” të përmbushin detyrimet e botimit për tekstin e vetëm të përbashkët “Abetare”, sipas paketës së dokumenteve “Mbi procedurat e zhvillimit të konkursit të tekstit të vetëm të përbashkët “Abetare”” dhe kërkesave të ministrive përgjegjëse.
3. Teksti i vetëm i përbashkët “Abetare” të përfshihet në katalogun e teksteve shkollore në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Kosovës.
4. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit e Republikës së Kosovës, Ministria e Arsimit dhe Sportit e Republikës së Shqipërisë, Komisioni i Përbashkët për procedurat e organizimit të konkursit për tekstin e vetëm të përbashkët të Abetares Shqipëri – Kosovë dhe shtëpitë botuese “Botime Pegi” dhe “Dukagjini” për zbatimin e këtij Vendimi/Urdhri.

Ky Vendim/Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT, SHKENCËS,
TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT

REPUBLIKA E KOSOVËS

ARBËRIE NAGAVCI



MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

EVIS KUSHI

